

PËRMBLEDHËSE (nga data 4 deri 10)

ZJARRET

Sot (dt.4) dhe nesër (dt.5): Niveli i rrezikut do të pësojë rritje në të gjithë territorin, më e theksuar në pjesën lindore, ku të gjitha qarqet do të kalojnë në nivelin "MESATAR" (siç tregohet në tabelë dhe hartë, respektivisht në faqet 2 dhe 3).

Pasnesër (dt.6) deri në datën 8: pritet rritje, por graduale, e nivelit të rrezikut pothuajse në të gjitha qarqet e vendit, më e ndjeshme në datën 8.

Dt.9-10: pritet rënie e rrezikut në të gjithë vendin, më e theksuar në pjesën qendrore dhe jugore të vendit.

PARASHIKIMI METEO :

RESHJET

Gjatë kësaj periudhë (dt.4 deri 10) në shumicën e ditëve NUK priten reshje, përjashtuar ndonjë reshje të izoluar, më e mundshme në terrenet kodrinore-malore gjate pasditeve; në përgjithësi, e dobët.

Reshjet pritet të ri-shfaqen në fund të ditës së premtë (dt.8) dhe pritet të vazhdojnë (me ndërprerje) përgjatë ditës së shtunë (dt.9).

TEMPERATURAT

Tendenca pritet të jetë, në përgjithësi, në rritje të lehta, por maksimumi i kësaj jave pritet të jetë rreth 2 gradë më i ulët se ai i javës së kaluar.

ERA

Në shumicën e ditëve do të ketë forcime të përkohshme të erës, zakonisht në ORËT E PASDITES, sidomos në bregdet dhe në terrenet e larta malore, ku mund t'i kalojë 30km/orë.

NIVELET E RREZIKUT

S'KA RREZIK

I ULËT

MESATAR

I LARTË



Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit – IGJEUM

PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	Ngjarje Klimatologjike	Ngjarje Meteorologjike				Ngjarje Hidrologjike		
	Zjarre në Pyje Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara	Rrufe	Shtrëngata	Përmbytje të Shpejta	Përmbytje Lumenjsh	Rrëshqitje toke
Shkodër	I ULËT	lokale	të dobëta					
Kukës	MESATAR	lokale	të dobëta					
Dibër	MESATAR							
Lezhë	I ULËT							
Durrës	I ULËT							
Tiranë	I ULËT							
Elbasan	MESATAR							
Fier	MESATAR							
Berat	MESATAR							
Korçë	MESATAR							
Vlorë	I ULËT							
Gjirokastrë	MESATAR							




LEGJENDA Reshjet 24-orëshe

Niveli i Rrezikut	Reshje shiu (mm / 24 orë)
S'KA RREZIK	të dobëta (0 - 15)
I ULËT	mesatare (15 - 45)
MESATAR	intensive (45 - 90)
I LARTË	shumë intensive (> 90)

LEGJENDA Zjarret

S'KA RREZIK	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht nga skuadrat e zjarrfikësve.
I ULËT	Nuk rekomandohen zjarret e kontrolluara, sepse bëhen vatra për ndezjen e zjarreve. Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë te mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara. Duhet të përdorim të gjitha mjetet për shuarjen e flakëve të zjarreve.
MESATAR	Ndezje mund të ndodhin lehtë me një përhapje të shpejtë në shkurre, barë dhe pyje. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme. Ndërhyrja direkte në kokën e zjarrit mund të jetë e pamundur, kërkohet ndihma e metodave dhe mjeteve të tjera plotësuese.
I LARTË	Ndezja mund të vijë edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë jashtëzakonisht të nxehtë me një përhapje shumë të shpejtë të flakëve. Kontrolli i tyre nuk mund të jetë i mundur gjatë ditës për shkak të rrezes së gjatë të përhapjes dhe të kurorës. Forcat e shuarjes duhet të përqendrojnë përpjekjet për të kufizuar përhapjen laterale të zjarrit. Dëmtim total i zonës.



	Shtrengata: reshje mbi 20 mm/3orë, moti mund të krijojë probleme të ndryshme
	Përmbytje urbane ose nga përrrenjtë dhe lumenjtë e vegjël
	Përmbytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj
	Rrëshqitje toke
	Mundësi për rrufe

